




GERILDI

Nga Kursant në Inxhinier Sigurie Kibernetike: Historia e Suksesit të Gerildit

Gerildi, një djalë 20-vjeçar nga Tirana, ka arritur të punësohet pas pjesëmarrjes në trajnimin e sigurisë kibernetike të organizuar nga FISA Academy. Ai tregon se këto trajnime i kanë dhënë njohuri të thelluara dhe aftësi praktike në fushën e sigurisë kibernetike. Aktualisht, Gerildi punon si inxhinier i sigurisë kibernetike dhe është mirënjohës për mundësitë që i janë ofruar për të avancuar në karrierën e tij.

Një projekt nga Agjencia Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:



"E mora vesh për trajnimin nëpërmjet disa miqve që punonin në FISA. Ata më informuan për këtë mundësi që do të zhvillohej së shpejti. Qëllimi im kryesor ishte të zgjeroja njohuritë e mia në fushën e kibernetikës. Gjithashtu, dëshiroja të njihja njerëz që punonin në këtë fushë dhe të krijoja miqësi të reja me individë të apasionuar pas teknologjisë, si unë," tregon Gerildi.

Gerildi ndoqi trajnimet e FISA Academy mbi sigurinë kibernetike, të cilat e ndihmuan në gjetjen e punës. Kurset e ndjekura pranë FISA-s e ndihmuan shumë Gerildin për të përvetësuar njohuritë e tij në fushën e sigurisë kibernetike. Trajnimet i mundësuan të thellojë aftësitë e tij duke u pajisur me teknika të avancuara. Gerildi ka mësuar hapat e parë drejt profesionit, ka marrë bazat e nevojshme të sistemit operativ Linux për hakim etik, ndërsa Ethical Hacking Fundamentals e ka pajisur me konceptet themelore të hakimit etik dhe sigurisë kibernetike. Këto kurse janë kombinimi ideal që e kanë ndihmuar të përmirësojë aftësitë e tij dhe të ndjekë një karrierë në këtë fushë.

"Trajnimi më ndihmoi duke më ofruar njohuri specifike për kibernetikën. Më vlejti shumë. Përveç njohurive që mora, pata mundësinë të intervistohem për një vend pune në kompaninë FIRST, ku tani punoj", shpjegon Gerildi.

"Më kanë pëlqyer aktivitetet dhe trajnimet e organizuara dhe do të merrja pjesë përsëri me kënaqësi. Aktualisht punoj si Inxhinier Sigurie Kibernetike në FIRST. Suksesi im më i madh është që arrita të siguroj një punë në profesionin që kam pasion, falë trajnimit që më dha mundësinë për një internship dhe më pas një vend pune", tregon ai.



A i kishte këto pritshmëri Gerildi ditën që shkoi të regjistrohej në kurs?

Ai nuk e fsheh se është shumë i kënaqur me trajnimin, eventin dhe mundësinë që iu ofrua. Gerildi pati mundësinë të përfitonte nga kjo sipërmarrje serioze që përveçse trajnon dhe punëson të rinj.

FISA Academy, një degë e kompanisë First Group e themeluar në vitin 2008, është specializuar në ofrimin e sistemeve të integruara për sigurinë kibernetike. Akademia u themelua në vitin 2021 si përgjigje ndaj kërkesës në rritje të tregut të ICT për çështjet e sigurisë kibernetike.

Kjo qendër trajnimi u krijua natyrshëm, si pjesë e grupit FIRST, për të plotësuar nevojën për profesionistë në fushën e Sigurisë Kibernetike. Qëllimi ishte krijimi i një rrjeti profesionistësh dhe forcimi i zinxhirit të vlerave njerëzore dhe potencialit të ekspertëve në këtë fushë, duke ndihmuar kështu bizneset dhe agjencitë qeveritare të rrisin kapacitetet e profesionistëve në këtë fushë.

Projekti RisiAlbania ka mbështetur FISA-n në zhvillimin e një studimi mbi kërkesën dhe ofertën e tregut për punonjës të sigurisë kibernetike, rritjen e kapaciteteve të instruktorëve të FISA përmes trajnimit të instruktorëve (TOT), zhvillimin e kurrikulave të reja mbi sigurinë kibernetike dhe organizimin e hackathon-it të FISA mbi këtë temë.

